

Organizatat europiane fact-checking miratojnë Kodin e standardeve profesionale për të luftuar dizinformimin

Mbi 40 organizata faktverifikuese (fact-checking) nga e gjithë Europa u dakordësuan mbi një Kod profesional që përcakton standardet e metodologjisë, etikës dhe transparencës të domosdoshme për të luftuar me efikasitet dhe integritet dizinformimin.

“Kodi europian i standardeve për organizatat e pavarura fact-checking”, i publikuar sot, u zhvillua në kuadër të një projekti që përfshiu organizatat faktverifikuese nga 30 shtete të Europës.

Kodi është rezultati i një pune disamujore kërkimore, anketash, debatesh dhe diskutimesh mes organizatave fact-checking europiane, në bashkëpunim me akademikë dhe ekspertë të fushës. Varianti përfundimtar i këtij Kodi u miratua nga 44 organizata nga 45 të përfshira në votim.

Standardet e Kodit përfshijnë çështje që nisin nga cilësia e burimeve, paanshmëria dhe transparenca financiare dhe janë një detyrim për t’u zbatuar nga të gjitha organizatat fact-checking që aspirojnë të bëhen anëtare të verifikuara të Rrjetit Europian të Standardeve Fact-Checking (*European Fact-Checking Standards Network, EFCSN*), i cili do të organizojë, mbështesë dhe përfaqësojë këtë komunitet. Anëtarësimi në këtë rrjet i tregon publikut se cilat organizata europiane fact-checking operojnë të pavarura, etike dhe me përkushtimin për t’i shërbyer interesit publik.

Me përmbajtjen e Kodit tashmë të miratuar, komuniteti i organizatave europiane fact-checking do të mbledhet në Madrid në fund të shtatorit për të diskutuar dhe përcaktuar misionin dhe strukturat e rrjetit, sikurse edhe trupën drejtuese që do të mbikqyrë zbatimin dhe respektimin e këtij Kodi.



Gjithashtu, në muajt e ardhshëm EFCSN do të mbështesë komunitetin e *Open Source Investigation* (OSINT), në hartimin e një grupi të veçantë udhëzimesh të përshtatura për punën dhe misionin e tyre.

Ky projekt është pjesë e *Call of Integrity of Social Media* i Komisionit European dhe udhëhiqet nga 6 organizata europiane të përkushtuara në luftën kundër dizinformimit: Fundación Maldita.es (Spanjë), AFP (Francë), CORRECTIV (Gjermani), DEMAGOG (Poloni), Pagella Politica/ Facta (Itali) dhe EU DisinfoLab (Belgjikë).

EFCSN mund ta ndiqni në Twitter dhe LinkedIn për t'u informuar me përditësimet e vazhdueshme mbi projektin.